

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6074
E martë, 28 korrik 2020
çmimi 0.40 €

Kosova nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit me EUROPOL-in | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

SERBËT DHE SERBIA KUNDËR SHQIPTARËVE DHE UÇK-SË E LUFTËS SË TYRE (18) F. 11



Shkruan:
Kudusi LAMA

30-VJETORI I TUBIMIT PËR PAJTIMIN E GJAQEVE NË ÇEGRAN TË GOSTIVARIT F. 11



Lulëzim
ETEMAJ

AKTUALE

ARRIHET KONSENSUS POLITIK PËR LIGJIN PËR MBROJTJEN E VLERAVE TË UÇK-SË F. 5



BIK-U VENDOS PËR FALJE TË KURBAN BAJRAMIT NËPËR XHAMIT, ME KUFIZIME F. 7



EKONOMI

SHKAKU I MUNGESËS SË KUORUMIT NË KOMISIONIN PËR TË DREJTAT E KOMUNITETEVE SHTYHET RISHIKIMI I BUXHETIT F. 9

SPORT

HAJDARI: GJILANI DO TA PREZANTOJË DENJËSISHT KOSOVËN NË LIGËN E EVROPËS F. 12

NË RRETHANAT AKTUALE, ANALISTËT POLITIKË KËRKOJNË ZGJERIM TË KOALICIONIT QEVERTISËS

ZGJERIMI I KOALICIONIT, I NEVOJSHËM

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar se koalicioni qeverisës po has në vështirësi për t'i siguruar votat e nevojshme për t'i kaluar ligjet në Kuvend. Ata kanë thënë se kjo e bën të nevojshëm

zgjerimin e koalicionit qeverisës. Sipas tyre, opsjon mbetet hyrja e PDK-së në qeveri. Albert Krasniqi dhe Behxhet Shala kanë deklaruar për gazeten "Epoka e re" se hyrja e PDK-së në qeveri do të varet

nga disa faktorë. Kundër zgjerimit të koalicionit qeverisës dëshiron se PDK-së nuk kanë dalë as LDK-ja, AAK-ja dhe Nisma, të cilët janë partnerët kryesorë të koalicionit aktual qeverisës



SEKTORI I GASTRONOMISË KËRKON NDIHMË NGA QEVERIA

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqçisht-Tetovë Curë-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVO
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta nuk shkarkohet nga posti i presidentit

TIRANË, 27 KORRIK - Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar rekomandimin e raportit për çështjen e shkarkimit të presidenti Ilir Meta. Me 78 vota për 68 vendosur që

presidenti Ilir Meta të mos shkarkohet sipas gjetjeve dhe të raportit që Ulsi Manja paraqiti më herët, i cili tha se shkeljet e presidentit Meta nuk janë të rënda deri në

shkarkim. Ndërkohë 17 vota ishin kundër dhe 8 abstenim. Historia e një viti debat u mbyll të hënën me rekomandimin për të bërë një ligj organik për institucionin e presidentit.



Ministrja Haradinaj-Stublla i kërkon kompanisë 'Apple' t'i njohë kufijtë e Kosovës



PRISHTINË, 27 KORRIK - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka njoftuar, në një shkrim publikuar në "Twitter", se më 23 korrik i ka nisur letër zyrtare shefit të kompanisë amerikane, "Apple", Tim Cook, për t'i përfshirë kufijtë e Kosovës në shërbimet për harta të kësaj kompanie. "Shërbimet për harta të 'Apple'-s nuk i shfaqin kufijtë e Kosovës të njohur ndërkombëtarisht. Në vend të kësaj, Republika e Kosovës shfaqet si pjesë e Serbisë. Kjo gjë

është në kundërshtim me realitetin politik dhe atë ligjor. Kjo gjë lëndon qytetarët tanë që janë përballur me humbje të mëdha në përpjekjet përvare. Kjo gjë shihet edhe si fyerje ndaj shtetit tonë", ka thënë ajo në letër. Ditet më parë këngëtarja e njohur britanike me origjinë nga Kosova, Dua Lipa, shkaktoi një varg reagimesh në rrjetet sociale pasi fillimi i ftoi kompaninë "Apple" nga profili i saj në "Instagram" që ta vendosë Kosovën në hartë, ndërsa më

pas postoi në "Instagram" dhe "Twitter" një fotografi të hartës së "Shqipërisë së Madhe" me mbishkrin "autochthonous" (autohton).

Në këtë hartë, përvçe Kosovës dhe Shqipërisë, përfshihen pjesë të Malit të Zi, Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë. Poshtë fotografisë, Dua Lipa ka shkruar: "Autokton - mbiemr (banor i një vendi), vendas, jo pasardhës të migrantëve ose kolonistëve". Përdoruesit e rrjeteve sociale në

Serbi kanë shprehur pakënaqësinë e tyre.

Të gjithë kësaj i ka paraprirë reagimi i këngëtarës së njohur ndaj një peticioni që kërkon që Kosova të mbahet në hartat e "Apple" me një yll, apo fusnotë, si pjesë e Serbisë.

Ky peticion aktualisht ka mbi 13 000 nënshkrues.

Peticioni i dytë, i cili ka rreth 93 000 nënshkrime, thotë se është shqetësuese që Kosova nuk tregohet në hartat e "Apple"-s. "Kufijtë e saj mezi shihen dhe më e keqja është se tregohet si

pjesë e Serbisë. Kjo duhet ndryshuar sa më shpejt që të jetë e mundur sepse Kosova është një vend i pavarur që nga viti 2008", thuhet në peticion. Edhe këngëtarja tjetër britanike me prejardhje nga Kosova, Rita Ora, ka kërkuar nga "Apple" që ta përfshijë Kosovën në hartat e saj. Aktualisht, kufijtë e Kosovës në hartën e kësaj kompanie janë vizatuar me ngjyrë të kuqe të zbehtë, ndryshe nga vendet e tjera që ndahen me një ngjyrë të ndritshme dhe një linjë e trashë.

Djali i Jonuz Musliut bëhet zëvendëskrytar i Komunës së Bujanocit

BUJANOC, 27 KORRIK (ER) - Djali i Jonuz Musliut, është emëruar zëvendëskrytar i Komunës së Bujanocit. Lajmin e ka bërë me dije vetë ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook".

"Pas konstituimit të institucioneve komunale javën e kaluar, sot filluan detyrën e re dhe periudhën e re. Si zëvendëskrytar i Komunës së Bujanocit do të bëj përpjekje përvancimin e të drejtave tona kombëtare si dhe përmirësimin e jetës së

qytetarëve tanë. Ky ishte mision i ish-liderit të LPD-së, Jonuz Musliut, e do të jetë mision dhe vizion i politikave tona për një jetë më të mirë në Bujanoc. Betejat tona nuk do të ndalojnë, sepse ato janë frymëzimi ynë", ka shkruar ai.



Kosova nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit me EUROPOL-in

Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me EUROPOL-in, ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka theksuar se sot është një ditë tejet me rëndësi për Republikën e Kosovës dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, veçanërisht Policinë e Kosovës, marrë parasysh se me nënshkrimin e marrëveshjes me EUROPOL-in, vendi ynë ka forcuar dhe avancuar kapacitetet në parandalimin dhe luftimin e krimtit të organizuar ndërkombëtar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimtit të rëndë. Pritet që shumë shpejt të dërgohet zyrtari ndërlidhës nga Policia e Kosovës në selinë qendrore të EUROPOL-it në Hagë

EPOKA ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 27 KORRIK - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme të hënën është mbajtur ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes së

bashkëpunimit me EUROPOL-in. Në këtë ceremoni morën pjesë Nataliya Apostolova, shefe e Zyrës së BE-së/Përfaqësuese e Posacme e BE-së në Kosovë, Rashit Qalaj, drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, si dhe të ftuar tjetër nga institucione vendore e ndërkombëtare.



trajtohet në mënyrë të barabartë, ashtu si policitë e shteteve të rajonit, të cilat kanë nënshkruar marrëveshje të tillë. Njëkohësisht, pritet që shumë shpejt të dërgohet zyrtari ndërlidhës nga Policia e Kosovës në selinë qendrore të EUROPOL-it në Hagë.

Në fund ministri Veliu ka falënderuar Apostolovën dhe përmes saj, EUROPOL-in dhe të gjitha strukturat e tjera të Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare përmes mbështetjen në përbolljen e këtij procesi mjaft të rëndësishëm, i cili forcon më tutje kriteret tashmë të plotësuara të liberalizimit të vizave, si dhe obligimet që burojnë nga Marrëveshja përmes Stabilizim-Asocii.

Ai, po ashtu, falënderoi përmes angazhimin të gjitha strukturat e Policisë së Kosovës, drejtorin e përgjithshëm, Rashit Qalaj, njëherësh uroi gjithë Policinë e Kosovës përmes këtë të arritur të merituar.

Shefa e Zyrës së BE-së/Përfaqësuesja e Posacme e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka përgëzuar autoritetet e zbatimit të ligjit të Kosovës dhe Europolin përmes këtë arritje të jashtëzakonshme. Ajo ka thënë se marrëveshja do t'i shumëfishojë kontaktet në të gjitha nivelet, duke e bërë Bashkimin Evropian dhe Kosovën më të sigurt.

Ndërkaq, drejtori Qalaj ka theksuar se e veçanta e kësaj marrëveshje është hapja rrugës e qasjes së Policisë së Kosovës në Kanalin e Sigurt të Komunikimit (i ashtuquajturi SIENA Channel) të EUROPOL-it. Me këtë marrëveshje Kosova barazohet me shtetet e tjera joanëtare në BE.

Me këtë rast ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka theksuar se sot është një ditë tejet me rëndësi për Republikën e Kosovës dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, veçanërisht Policinë e Kosovës, marrë parasysh se me nënshkrimin e marrëveshjes me EUROPOL-in, kemi forcuar dhe avancuar kapacitetet tonë në parandalimin dhe luftimin e krimtit të organizuar ndërkombëtar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimtit të rëndë. Ai ka thënë se deri më tanë shkëmbimi i informacioneve me EUROPOL-in është kryer përmes Deskut Suedez në kuadër të EULEX-it, e që ka krijuar vonesa në shkëmbimin e informatave dhe kryerjen e operacioneve policore. Ministri Veliu vuri në dukje se përmes kësaj marrëveshje Policia e Kosovës do të

Thaçi dhe Hyseni diskutojnë nevojën e mbështetjes së deputetëve përmirësuar

PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të hënën e ka pritur në takim Koordinatorin Shtetëror përmirësuar Dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Skënder Hysenin.

Presidenti Thaçi e ka uruar përmirësimin në këtë detyrë, duke shprehur besimin se me përvojën dhe angazhimin e tij, Hyseni do ta koordinojë këtë proces në mënyrën më të mirë të mundshme. "E kam mirëpritur emërimin tuaj koordinator përmirësuar Dialogun sepse besoj fuqishëm në përvojën dhe qasjen tuaj gjithëpërfshirëse e përafruese

mes gjithë spektrit politik në vend", është shprehur presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka ritheksuar se në Bruksel duhet të dialogohet vetëm përmirësuar përfundimtare që sjell njohjen reciproke ndërshtetërore.

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi dhe koordinatori përmirësuar, Skënder Hyseni, kanë biseduar edhe përmirësuar reciproke ndërshtetërore. Presidenti i vendit, Hashim Thaçi dërgoi një mesazh përmirësuar për koordinatorin Hyseni, që krijuar vonesa në shkëmbimin e informatave dhe kryerjen e operacioneve policore.



Në rrethanat aktuale, analistët politikë kërkojnë zgjerim të koalicionit qeverisës

Zgjerimi i koalicionit, i n



Njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar se koalicioni qeverisës po has në vështirësi për t'i siguruar votat e nevojshme për t'i kaluar ligjet në Kuvend. Ata kanë thënë se kjo e bën të nevojshëm zgjerimin e koalicionit qeverisës. Sipas tyre, opzioni mbetet hyrja e PDK-së në qeveri. Albert Krasniqi dhe Behxhet Shala kanë deklaruar përgazetën "Epoka e re" se hyrja e PDK-së në qeveri do të varet nga disa faktorë. Kundër zgjerimit të koalicionit qeverisës dhe hyrjes së PDK-së në qeveri nuk kanë dalë as LDK-ja, AAK-ja dhe Nisma, të cilët janë partnerët kryesorë të koalicionit aktual qeverisës

**EPOKA
ERE** **Muhamed KOCI**

PRISHTINË, 27 KORRIK - Njohësit e rrethanave politike në vend e shohin të nevojshëm zgjerimin e koalicionit qeverisës. Ata kanë vlerësuar se qeveria aktuale është e brishtë në numra dhe se përballja me sfidat të cilat e presin Kosovën e bëjnë të pashmangshme zgjerimin e koalicionit. Sipas tyre, opzioni më i mundshëm është përfshirja e PDK-së në këtë qeveri. "Në rrethana të tillë, funksionaliteti i qeverisës rrezikohet dhe pashmangshëm kërkon ose zgjerim të

koalicionit, ose shpërndarje të Kuvendit për t'u hapur rrugë zgjedhjeve jashtëzakonshme. Përfshirja e PDK-së në koalicion qeverisës është një skenar i mundshëm, por ekziston edhe një mundësi tjetër që PDK-ja të mos përfshihet në qeveri, por ta ketë përkrahjen e partnerëve të koalicionit për ta zgjedhur presidentin nga radhët e veta kurdo që do të ndodhë kjo, si dhe ta luajë rolin e opozitës konstruktive, duke i votuar disa prej ligjeve të rëndësishme të qeverisë, siç mund të jetë Ligj për Buxhetin, si dhe duke i dhënë besimin në rast të ngritjes së mociioneve të mosbesimit", ka thënë Albert Krasniqi përgazetën "Epoka e re". Ai ka treguar se si mund të duket në praktikë mbështetja e PDK-së për qeverinë. "Në sistemin parlamentar të Uestministerit, kur partitë politike opozitare nuk marrin poste ministrore në qeveri, por që jepin mbështetjen për qeverinë në këmbim të shtyrjes përpara të politikave të caktuara, njihet si besim-dhe-mbështetje (confidence-and-supply). Një skenar i tillë do të ishte në interes edhe të qeverisë, pasi do t'i ofronte më

shumë stabilitet, por edhe të PDK-së, e cila do ta kishte të drejtën e propozimit të presidentit dhe t'i shmanget zgjedhjet, sidomos në këtë kohë kur lideri i saj është duke u përballur me akuza nga Gjykata Speciale", ka thënë Krasniqi.

Edhe analisti tjetër politik Behxhet Shala e sheh shumë të mundshëm skenarin e përfshirjes së PDK-së në qeveri. Sipas tij, ky veprim mund të ndikohet nga epilogu i akuzave të Speciales ndaj presidenti Hashim Thaçi dhe lideri të kësaj partie, Kadri Veseli. "Kjo krejt varet prej epilogut që do të ketë propozimaktakuza e Gjykatës Speciale ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. Nëse aktakuza konfirmohet, situata do të ndryshojë rrënjesisht. Atëherë domosdoshmërisht do të bëhet një ridizajnim i skenës politike të Kosovës. Pra, do të kemi një situatë që edhe PDK-ja do të përfshihet në qeveri dhe do të bëhet pjesë e dialogut. Nuk ka kuptim që

PDK-ja ta përkrahë marrëveshjen me Serbinë duke qëndruar në opozitë", ka thënë ai, duke shtuar se mbështetja e PDK-së për qeverinë është e domosdoshme. "PDK-ja është në një pozitë që tash për tash më shumë ka nevojë LDK-ja për PDK-në sesa kjo fundit për LDK-së. Sepse LDK-ja me këtë koalicion qeverisës nuk mund ta arrijë asnjë marrëveshje, madje kemi parë që nuk po mund ta kalojë as buxhetin e lëre më ta ratifikojë ndonjë marrëveshje ndërkombëtare. Por, nëse PDK-ja dhe LV-ja bëjnë ndonjë marrëveshje në opozitë, shumë shpejt mund të kemi zgjedhje të reja. Mirëpo gjithë jemi dëshmitarë që as faktori ndërkombëtar e as partitë e tjera në Kosovë nuk janë të gatshme për zgjedhje të reja. Sepse dihet që në zgjedhje do të fitonte LV-ja, por nuk do të fitonte sa po mendojnë ata", ka thënë Shala.

Se epilogu i akuzave të para të Gjykatës Speciale mund të ketë ndikim në zgjerimin e koalicionit qeverisës e ka thënë

evojshëm



Arrihet konsensus politik për Ligjin për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 KORRIK - Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka mbajtur të hënën tryezë diskutimi për projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së i cili në legjislaturën e kaluar është iniciuar nga kryetari i PDK-së, Kadri Veseli. Në emrët e grupit parlamentar të PDK-së, deputeti Gazmend Bytyçi ka ftuar në tryezë përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe përfaqësuesit e organizatave të luftës së UÇK-së ku, pas diskutimeve, kanë arritur konsensus të plotë për ta mbështetur miratimin e projektligjit. Në këtë tryezë ishin të pranishëm përfaqësues të grupeve parlamentare nga Vetëvendosja, LDK-ja, AAK-ja dhe 6+.

Deputeti i PDK-së, Gazmend Bytyçi, pasi i ka falënderuar përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe përfaqësuesit e organizatave të luftës së UÇK-së, ka thënë se qëllimi mbajtjes së kësaj tryezë diskutimi është unifikimi i skenës politike për nxjerrjen e një ligji sa më të mirë

për vlerat e luftës. "Jemi në një tryezë bashkëbisedimi për Ligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës. Siç e dini, ky ligj është iniciuar në vitin 2018 nga kryetari i Kuvendit të asaj kohe, Kadri Veseli. Me ndryshime të qeverisë së atëherëshme ky ligj ka mbetur pa kaluar nëpër procedura dhe pa u miratuar. Si të tillë, më 27 prill të këtij viti, në emrët e grupit parlamentar të PDK-së e kemi riinicuar këtë ligj dhe tanjemi në fazën e punimit dhe draftimit të këtij ligji. Arsyja e kësaj tryze është që ne si përfaqësues të partive politike së bashku me shoqatat e dala nga lufta ta gjemjë formën e modalitetin më të mirë se si ta trajtojmë këtë ligj. Me aq sa shihet, ekziston një vullnet për një unitet të madh politik që këtë ligj ta trajtojmë pa dallime politike", ka thënë ai.

Deputetja e LDK-së, Valentina Bunjaku, e cila është edhe kryetare e Komisionit Funksional Parlamentar për trajtimin e këtij projektligji, ka thënë se e mbështesin miratimin e tij dhe do ta jep kontributin e tyre edhe si komision, por edhe si parti politike në mbështetje të tij.

"Në kuadër të komisionit të arsimit ka ardhur ky projektligj që të shqyrtohet në komisionin tonë dhe gjithë anëtarët e komisionit kanë përkrahur unanimisht këtë ligj. Pa hezitim do ta jepim kontributin tonë që të pasurojmë këtë ligj me propozimet tona si LDK dhe ky projektligji do të ketë përkrahjen tonë të parezervë në Kuvend porsa të përpilojet dhe të vihet në votim", ka thënë ajo.

Edhe përfaqësuesi i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari, ka thënë se hartimi i Ligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës është i domosdoshëm. "Ligji i veçantë për kategori të veçanta. Është mirë që sot bashkërisht do të punojmë dhe t'i jepim qëndrimet tona dhe besoj se do të bëjmë një ligj që do t'i mbrojë kategoritë e shenja të luftës së UÇK-së", ka thënë Jashari.

Të pranishmit në tryezë u zotuan se do ta votojnë të plotë Ligjin për vlerat e luftës dhe ndërmjet dy leximeve në Komisionin Funksional do t'i jepin kontributet e tyre me amendamente në leximin e dytë.



edhe kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati. "Kjo është brengosëse. Në anën tjetër duket se ka gjasa që kjo qeveri ka vullnet për t'u zgjeruar edhe me PDK-në, sidomos pas krizës së fundit rreth ngritjes së aktakuzës për presidentin dhe z. Veseli. Sidoqoftë, cili do të jetë qëndrimi i PDK-së mbetet për t'u parë. Nuk duhet harruar se në lojë do të jetë edhe pozicioni i presidentit vitin e ardhshëm, apo pas ndonjë dorëheqjeje të mundshme të z. Thaçi e për të cilin nëse nuk ka një konsensus më të gjërë, vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja", ka thënë Murati në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re"

Partnerët nuk janë kundër zgjerimit të koalicionit qeverisës

Pro zgjerimit të koalicionit qeverisës janë edhe vetë partnerët aktualë të koalicionit qeverisës. Ata nuk e kanë

kundërshtuar mundësinë e futjes së PDK-së në qeveri. Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka dekluaruar hapur se është pro përfshirjes së PDK-së në qeveri. Sipas tij, do të ishte në interesin e Kosovës që sa më shumë vota shqiptare të ketë ky koalicion qeverisës. "Jetëgjatësia e kësaj qeverie varet edhe nga mandati i presidentit. Nëse ka befasi dhe konfirmohen aktakuzat, neve na duhet kuorumi për ta zgjedhur presidentin. Një qeveri më e madhe me më shumë vota shqiptare është në interes të Kosovës. Nëse PDK-ja dëshiron të jepë kontributin e vet mund të bashkëpunojmë", ka thënë Haradinaj.

As Nisma Socialdemokrate nuk është kundër zgjerimit të koalicionit aktual qeverisës. Sekretari i Përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka thënë për "Epokën e re" se për këtë çështje u takon të vendosin liderët e koalicionit qeverisës. "Nisma Socialdemokrate e

Kosovës nuk është kundër zgjerimit të qeverisjes me të gjithë ata që janë të interesuar të kontribuojnë që të dalim fitimtarë në të gjitha sfidat që kemi përballë, mirëpo kjo çështje u takon forcave politike dhe liderëve të tyre nëse do të udhëhiqen nga një qasje prej burrështetasve që tekalon këndvështrimin e ngushtë partiak apo do të vazhdojnë të udhëhiqen nga interesa vetëm partiake", ka thënë Sherifi.

Një mundësi e tillë nuk është kundërshtuar nga zyrtarët e lartë të LDK-së e cila e udhëheq qeverinë. Kryeministri Avdullah Hoti nuk ka dashur

të komentojë këtë çështje kur është pyetur. "Ju gjithmonë e dini qasjen time se si i trajtojmë këto gjëra. Asnjëherë nuk përgjigjem në asnje pyetje hipotetike. Qeveria është plotësisht stabile. Presidenti është me mandat të plotë. Nëse krijohen ato rrëthana, do të ulemi dhe do të gjemjë zgjidhjet më të mira përvendin", ka dekluaruar Hoti.

Partia Demokratike e Kosovës ka treguar një qasje më të butë ndaj qeverisë aktuale se Lëvizja Vetëvendosje, e cila është partia më e madhe në vend. PDK-ja, ndonjëse ka votuar kundër formimit të qeverisë Hoti, ajo ka votuar pro disa

marrëveshjeve ndërkombëtare në kuvend dhe pro miratimi të Ligjit për ndryshimin e buxhetit.

Zyrtarët e lartë të PDK-së e kanë mohuar përfshirjen e tanishme të kësaj në qeveri. Por, ka zyra të kësaj partie që publikisht janë shprehur përfshirje në qeveri. Anëtarë i kryesisë së PDK-së, Sami Lushtaku, ka thënë se në situatën në të cilën ndodhet PDK-ja, pas zhvillimeve me Gjykatën Speciale, më mirë është të përfshihet në qeveri. Në anën tjetër, Lëvizja Vetëvendosje e ka mohuar çdo mundësi që të bëhet pjesë e qeverisë në këtë legjislaturë.

RrGK-ja kërkon drejtësi të pakompromis për vrasjen e gruas nga bashkëshorti në Kamenicë


KAMENICË, 27 KORRIK (ER) - Rrjeti i Grave i Kosovës (RrGK) me shqetësim tejet të madh ka pranuar lajmin për vrasjen që ka ndodhur para dy ditësh në fshatin Berivojcë të Komunës së Kamenicës, ku një burrë rreth moshës 42-vjeçare me inicialet N. M. e ka vvarë gruan e vet 34-vjeçare me shufër metalike.

Përmes këtij reagimi, RrGK-ja u ka bërë thirrje institucioneve të drejtësisë, respektivisht Gjykatës Themelore të Gjilanit që është duke e trajtuar rastin, që të ketë kujdes të shtuar për

trajtim të këtij rasti dhe që dorasi ta marrë dënimin e merituar ashtu siç parashihet me ligj për kryerjen e veprës penale "vrasje e rëndë", vepër e sanksionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Duke pasur për bazë gjetjet e hulumtimeve të realizuara nga RrGK, shpeshherë është vënë re se gjyqtarët, prokurorët, si dhe zyrtarët policorë, gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje, kanë tendencë ta fajësojnë viktimin, madje edhe kur të gjitha provat dëshmojnë për dhunë me pasoja të rënda

fizike dhe emocionale. "Andaj, RrGK do ta monitorojë për së afërmë këtë rast, për t'u siguruar që drejtësia do të zbatohet. Për çdo dështim, nga institucionet do të kërkojmë përgjegjësi përmosfikasitet dhe pandëshkueshmëri të vrasësve të grave. Ne do të ushtrojmë presion publik në rast se nuk ndërmarrë hapat e duhur ligjorë. Në kërkim të drejtësisë, RrGK do të ndërmarrë një aksion në ditët në vijim, për të cilin mediat do të njoftohen me kohë", është bërë me dije në reagimin e RrGK-së.



KFOR-i turk shpërndan dhurata për fëmijët e mbrojtur në Gjilan



GJILAN, 27 KORRIK (ER) - KFOR-i turk në Gjilan ka shpërndarë të hënën dhurata për fëmijët e mbrojtur, në vigjilje të festës së Kurban Bajramit. Në ceremoninë e shpërndarjes ka marrë pjesë kontingenti turk në krye me kolonelin Behlul Behluli si dhe i pari i Gjilanit, Lutfi Haziri. Kryetari Haziri e ka falënderuar KFOR-in dhe popullin turk përmështetjen e vazhdueshme

ndaj Gjilanit në shumë fusha. "Në vigjilje të festave të Bajramit, armata turke tradicionalisht shpërndan dhurata për fëmijët e Komunës së Gjilanit. Ne sot e kemi zgjedhur kategorinë e mbrojtur, të cilët i kemi mbështetur gjatë kohës së pandemisë, ndërkohë që këtë festë të Kurban Bajramit i kemi përzgjedhur përmështetjen e vazhdueshme

tyre edhe si armatë, politikë e diplomaci. TIKA dhe Ambasada Turke janë partnerë të mëdhenj zhvillimor në Komunën e Gjilanit, ndërkohë që kemi mbështetur gjatë kohës së pandemisë, ndërkohë që këtë festë të Kurban Bajramit i kemi përzgjedhur përmështetjen e vazhdimësi", ka shtuar Haziri.

Të gjitha rrugët në Fshatin e Ri në Malishevë do të asfaltohen

MALISHEVË, 27 KORRIK (ER) - Fshati i Ri, i cili është një prej fshatrave më të thella në Komunën e Malishevës, së shpejti do të bëhet me rrugë të rregulluara dhe të asfaltuara, pasi kanë filluar punimet përrugëve të mbetura. Bëhet fjalë për rrugët 800 metra rrugët në lagjet e këtij fshati, të cilat kanë filluar të hapen përmështetjen e vazhdueshme

njoftuar nga mbikëqyrësi përpunimet që janë duke u bërë si dhe nga kryetari i fshatit Arton Zogaj dhe punëkryesi.

Drejtori Morina, gjithashtu, është takuar edhe me banorët të cilët i ka uruar përmështetjen e rrugëve, ndërsa është ndarë i kënaqur me punët që aktualisht janë duke u kryer, marrë parasysh edhe terrenin e thepisur në këtë fshat të thellë malor.

Nga ana tjetër, edhe kryetari i fshatit, Arton Zogaj, e ka falënderuar komunën përmështetjen e vazhdueshme

rregullimin e rrugëve në disa lagje të fshatit, pasi kanë rëndësi jetike për banorët, përmështetjen e rrugëve, ndërsa është ndarë i kënaqur me punët që aktualisht janë duke u kryer, marrë parasysh edhe terrenin e thepisur në këtë fshat të thellë malor. Nga ana tjetër, edhe kryetari i fshatit, Arton Zogaj, e ka falënderuar komunën përmështetjen e vazhdueshme



Kompletohet infrastruktura në rrugën nga Xhamia dhe Kisha deri te Teatri



FERIZAJ, 27 KORRIK (ER) - Pas rregullimit të trotuareve, mbjelljes së drunjve dekorativë, të hënën është kompletuar edhe me një shtresë asfalti segmenti i rrugës "Dëshmorët e Kombit", përkatesisht pjesa nga Teatri "Adriana" deri te Xhamia e Madhe dhe Kisha Ortodokse. Zhvillimi i këtij projekti flet përmështetjen e vazhdueshme

infrastrukturën e munguar përdokada në zonën e qendrës së qytetit. E përmështetjen e vazhdueshme

projekt do të sjellë dobi të shumta përmështetjen e vazhdueshme

276 raste të reja me Covid në Kosovë, plus tetë të vdekur

Në 24 orët e fundit në Kosovë janë konfirmuar edhe 276 raste të reja me Covid-19. Rastet e reja kanë dalë nga testimi i 404 mostra. Po në 24 orët e fundit janë regjistruar tetë viktima nga ky virus, duke e çuar në 185 numrin e tyre. Drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, Naser Ramadani, ka paralajmëruar se situata në sistemin shëndetësor është e mbingarkuar.

**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRIHTINË, 27 KORRIK - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë testuar gjithsej 404 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 276 raste pozitive me Covid-19. Po 24 orët e fundit janë regjistruar tetë viktima nga koronavirusi.

Numri total i rasteve pozitive në Kosovë është 7 413 raste, me gjithsej 185 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 153 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 4 027 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 201. Duke folur në një konferencë për media, drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë

Publike të Kosovës, Naser Ramadani, ka thënë se shifra është rekordi dhe ka paralajmëruar se situata në sistemin shëndetësor është e mbingarkuar.

Lindita Ajvazaj-Berisha, drejtoreshë e Klinikës Infektive në Prishtinë, ka thënë se në klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet e përgjithshme janë të shtrirë gjithsej 385 pacientë me koronavirus dhe se 43 janë në gjendje kritike.

Në konferencën për media në Prishtinë ka marrë pjesë edhe ministri i Shëndetësisë, Armond Zemaj, i cili ka thënë se ministria që drejton ai ka shpérndarë 200 profesionistë shëndetësorë shtesë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet e përgjithshme, për të ndihmuar në trajtimin e pacientëve. Zemaj, po ashtu, ka thënë se ka nisur edhe procesi i licencimit të institucioneve private për testimin serologjik të qytetarëve.



Gjysmë milion maska do të shpërndehen në 38 komuna të Kosovës

Nga sot (e martë) do të bëhet shpérndarja e 500 000 maskave, 30 000 dezinfektuesve, 5 000 kominosheve dhe 10 000 mantilave në 38 komuna të Republikës së Kosovës. Lajmin e ka bërë me dije zëvendëskryeministri Besnik Tahiri, duke shtuar se kjo shpérndarje do të bëhet në bazë të kriterit të popullsisë për komunë dhe sipas urgjencës që e përcakton Ministria e Shëndetësisë.

BIK-u vendos përfalje të Kurban Bajramit nëpër xhami, me kufizime

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRIHTINË, 27 KORRIK - Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) ka njoftuar se falja e Kurban Bajramit të premten do të bëhet në xhami por, me kufizime, duke marrë parasysh pandeminë Covid-19. Sipas BIK-ut, xhemati do të jetë në xhami 10 minuta para faljes së Kurban Bajramit, që do të bëhet në orën 06:03 të mëngjesit. Ligjëratë nuk do të zgjasë më tepër se dhjetë minuta, ndërsa



sa ligjëratat e ditës së xhuma nuk do të zgjasin më tepër se

xhemati do t'u përbahen me përpikëri rekandimeve për mbrojtje ndaj përhapjes së virusit, si dezinfektimi i duarve, mbajtja e maskave dhe distanca fizike.

Numri i besimtarëve në xhami do të jetë 50 persona, apo edhe më pak, varësish nga hapësira e xhamisë. Nuk do të lejohen personat mbi moshën 65-vjeçare dhe ata më të ri se 16 vjeç si dhe personat me sëmundje kronike, ata që kanë simptoma të virusit apo çdokush që dyshon se mund të infektohet në xhami.

Po ashtu, është thënë se nuk do të lejohet shfrytëzimi i tualeteve, abdeshaneve dhe banjave të përbashkëta në oborret e xhamive. Nuk duhet të ketë përshëndetje me duar. Po ashtu, nuk do të lejohet grumbullimi i turmave. Po ashtu, nuk do të ketë pritje për njer të Bajramit në selinë e BIK-ut e as në selitë e këshillave lokale. "Për hir të ruajtjes së shëndetit, që në këtë rast është parësor, të mos ketë vizita te njëri-tjetri ditëve të Kurban Bajramit", është thënë në njoftimin e BIK-ut.

Grupi parlamentar i AAK-së dhe përfaqësuesit e saj në qeveri koordinohen për temat kombëtare

PRIHTINË, 27 KORRIK (ER) - Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka zhvilluar të hënën një takim me zëvendëskryeministrin Besnik Tahiri dhe zëvendës-


ministrat nga radhët e kësaj partie. Sipas njoftimit të grupit parlamentar të AAK-së, takimi është mbajtur në lidhje me zhvillimet dhe ngjarjet me rëndësi përvendin. "Theks i

veçantë i këtij takimi ishte situa atë aktuale me pandeminë si dhe rimëkëmbja ekonomike që është e domosdoshme në këtë periudhë të vështirë përvendin. Gjithashtu, u morën

vesh për bashkëveprim të grupit parlamentar dhe zëvendësministrave me qëllim që të shtyhen përpëra temat e interesit kombëtar", ka njoftuar grupi parlamentar i AAK-së.



30-vjetori i tubimit për pajtimin e gjaqeve në Çegran të Gostivarit



Lulëzim ETEMAJ

Pak kohë pasi në vitin 1990 kishte filluar në Pejë nga studentët, ish të burgosur politikë, Myrvete Dreshaj, Have Shala, Brahim Dreshaj, Adem Grabovci dhe Lulëzim Etemaj, pajtimit të gjaqeve, plagëve dhe ngatérresave i ishin bashkangjitur, krahas qyteteve të tjera, edhe Tetova e Gostivari. Adnan Abdullahi-Voka, Afrim Ibrahimi-Fanda, ish i burgosur

dhe Gostivar. Pajtimi i parë i arritur prej tyre në fshatin Trebosh ka shërbyer edhe si një motiv tjetër shtesë për ta rritur përkushtimin e tyre dhe për ta bartur barrën kryesore të punës në terren, si dhe të koordinimit dhe bashkërendimit, qoftë në këtë anë, qoftë me nismëtarët e Aksionit për Pajtimin e Gjaqeve në Kosovë apo Lëvizjen në përgjithësi.

Kësaj bërrthame më vonë i bashkëngjiten edhe veprimtarët të tjerë, si Mehmetira Murtezani-Gega, organizator i demonstratave të vitit 1968 në Tetovë, ish i burgosur politik dhe njëherazi, ashtu si Adem Demaçi në Prishtinë, prijës kryesor shpirtëror i irredentizmit shqiptar në këtë anë;



Ahmeti, Fatime Fejzullahi, vëllezërit ish-të burgosur politikë, Vebi dhe Remzi Beqiri, Luan Veliu, Isak Sherifi, Xhevati Ademi, ish i burgosur politik, profesorët Fadil Sylejmani dhe Ramadan Sinani, po ashtu një nga organizatorët e demonstratave të vitit 1968 në Tetovë, si dhe ish i burgosur politik. Veprimtarinë e këtij këshilli, krahas Myervete Dreshajt dhe Lulëzim Etemajt, e ndihmuani më vonë edhe Luljeta Grabovci, Naim Xhuraj, Adem Grabovci, Ibish Neziri, si dhe veprimtarë të tjerë nga rrathi i Pejës, por edhe nga vende të tjera.

Si rezultat i angazhimit të shkëlqyeshëm të veprimtarëve të shumtë, si dhe gatishmërisë për të falë gjaqe, plagë e ngatérresa, të treguar nga familjet e dëmtuara, më 28 korrik 1990 mbahet në Çegran të Gostivarit tubimi madhështor për pajtimin e gjaqeve. Në "Rudinën e Pajtimit", bri Malit të Thatë, edhe përkundër masave të repta policore të pushtetit maqedonas për të penguar me anë të ndalimit të veturave dhe legitimimit e marjes në shënim të pjesëmarrësve, për të qenë pjesëtarë të Besëlidhjes së

Gostivarit, arritën të tubohen 50 mijë veta nga të gjitha trojet shqiptare. Në këtë ditë festë u bë promovimi i shtrirjes së dorës së pajtimit nga 9 familje: u falën 3 gjaqe dhe 6 ngatérresa. Përgatitjen e tubimit e ndihmuani, veç të tjerëve, nismëtarët e pajtimit të gjaqeve Myrvete Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj, të cilët që nga data 1 maj, kohën më të madhe e kishin kaluar në organizimin e këshillave dhe shtrirjen e pajtimit të gjaqeve, plagëve dhe ngatérresave edhe në këto anë. Në tubim morën pjesë gjithashtu edhe veprimtarë të tjerë të pajtimit të gjaqeve, si Adem Grabovci, dr. Zekeria Cana, dr. Hajrullah Gorani, ish i burgosur politik, dr. Hakif Bajrami etj.

Për kontributin e dhënë në organizim dhe shtrirjen e Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve edhe në viset shqiptare nën Maqedoni, Këshilli i Pajtimit dhe Dega e Partisë së Prosperitetit Demokratik në Gostivar shpërblyen me mirënjohje publike pesë nismëtarët e Pejës të Aksionit për Pajtimin e Gjaqeve në Kosovë, me pllakatin e pajtimit: dy duar të

lidhura me mbishkrimin "Rudina e Pajtimit '90". Në emër të nismëtarëve shpërblimin e pranoi studentja Myrvete Dreshaj, e cila duke falenderuar për përkrahjen që kishin gjetur nismëtarët e pajtimit të gjaqeve dhe nisma e tyre edhe në këtë anë, do t'u drejtobet me një fjalë të shkurtër pjesëmarrësve në Kuvend, ku, përvèç të tjerash, do të theksojë: "Kështu, të bashkuar, do t'i bëjmë të paqenë kufijtë midis tokave shqiptare, të cilët po bën përpjekje t'i forcojë edhe pushteti i Maqedonisë së sotme, dhe do të arrijmë lirinë dhe bashkimin kombëtar".

Sigurisht që policia shoviniste maqedonase s'do të qëndronte indiferente as në këtë rast, prandaj kishte marrë masat e nevojshme për arrestimin e Myrvete Dreshajt. Mirépo edhe ana tjetër s'kishte qëndruar duarkryq: pas maskimit që i kishte bërë asaj, e tërheq dhe e strehon në një shtëpi ku kishte siguri më të madhe.

(Shkëputur nga libri "Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1991")



politik, Dashmire Rizvani, Resmije Abdurrahmani, Hyrjet Tahiri e Besime Muharremi përbëjnë bërtamën e parë të nismëtarëve të Aksionit për Pajtimin e Gjaqeve në Tetovë

Valdete Fejzullahi, Nafije Zendeli, ish e burgosur politike, Tahir Abdulla, Afërdita Ceka, Mensur Fejzullahi, Naser Veliu, Izet Fejzullahi, Nuredin Aliji, vëllezërit Xhevati e Nexhat



Protestojnë gastronomët, ‘dorëzojnë’ çelësat para objektit të Qeverisë së Kosovës për shkak të kufizimeve

Sektori i gastronomisë kërkon ndihmë nga qeveria

Përfaqësuesit e bizneseve të gastronomisë në Kosovë të hënën kanë protestuar para objektit të qeverisë, duke kërkuar që ky sektor, që është goditur nga pandemia Covid-19, të ndihmohet. Shoqata e Gastronomëve ka paraqitur disa kërkesa të cilat duhet të përfshihen në rishikimin e buxhetit. Pas kësaj proteste, kryeministri Avdullah Hoti është takuar me një delegacion të Shoqatës së Gastronomëve, ku ka premtuar përkrahje për bizneset

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 27 KORRIK - Përfaqësuesit e bizneseve të gastronomisë në Kosovë sot protestuan para Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar që ky sektor, që është goditur nga pandemia e koronavirusit, të ndihmohet. Përfaqësuesit e gastronomisë në mënyrë simbolike hodhën para qeverisë “çelësat” e bizneseve të tyre. Petrit Kllokoqi nga Shoqata e Gastronomëve të Kosovës tha se ky sektor padrejtësish është akuzuar nga autoritetet si “shpërndarës i koronavirusit”. “U bëj thirrje qeverisë dhe par-

lamentit, kaljeni buxhetin, ndihmojeni biznesin sepse është koha e fundit që mund ta tregoni veten. I bëj thirrje qeverisë, pas dy javësh me orar të shkurtuar, me idenë që jemi shpërndarës të virusit, e që nuk doli ashtu, që ta kthejë orarin deri në orën 12:00 (v.j. 24:00)”, ka thënë ai.

Në fillim të muajit korrik, Qeveria e Kosovës vendosi që t'i rikthejë disa masa kufizuese për ta parandaluar përhapjen e mëtejmë të koronavirusit. Një ndër to ishte që bizneset e gastronomisë të mos punojnë nga ora 21:00 deri në orën 5:00. Qeveria e Kosovës ka thënë se me rishikimin e buxhetit do të



përfshihet edhe një fond i rimëkëmbjes për t'i ndihmuar bizneset e goditura nga pandemia e koronavirusit. Andaj, Shoqata e Gastronomëve, ka thënë Kllokoqi, ka disa kërkesa që duhet të përfshihen në rishikimin e buxhetit. “Kërkesat tonë janë: subvencionim i pagave, mbulim 50 për qind i qirasë, shtyrje të pagesave të deklarimeve, riprogramim i kredive dhe ulje e TVSh-së në 8 për qind. Për sallat e dasma e diskotekave që nuk kanë punuar sivjet, kërkohmë rim-

bursim financiar, konformatimeve të paguara nga këto biznese”, ka thënë ai, duke paralajmëruar se në të kundërtën bizneset e gastronomisë nuk do të jalin përgjegjësi fiskale nëse autoritetet nuk plotësojnë kërkesat e tyre. Pas kësaj proteste, kryeministri Avdullah Hoti është takuar me një delegacion të Shoqatës së Gastronomëve. Në njoftimin e qeverisë thuhet se Hoti ka biseduar me gastronomët përgjendjen e këtij sektori të biznesit dhe vështirësitë me të

cilat po përballen. “Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur në takim një delegacion të Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës, me të cilët ka biseduar përgjendjen e këtij sektori të biznesit dhe vështirësitë me të cilat po përballet në situatën aktuale të pandemisë Covid-19. Pasi që është njoftuar nga delegacioni i gastronomëve përgjendjen e këtij sektori, kryeministri Hoti ka shprehur gatishmërinë e Qeverisë së Kosovës që t'i mbështhesë të gjitha veprimtaritë ekonomike dhe bizneset në Kosovë, me qëllim që të tejkalojë situata e krijuar”, thuhet në njoftimin qeverisë.

Sipas njoftimit të qeverisë, është theksuar se masat e Pakos për Rimëkëmbjen Ekonomike, si pjesë e programit qeverisës, do ta lehtësojnë përballimin e gjendjes së krijuar nga pandemia. “Gjatë këtij takimi u kerkua që gastronomia t'i respektojë me përpikëri masat e parapara ndaj Covid-19 në mënyrë që mos rrezikohet shëndeti i klientëve”, është thënë në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

Mungesa e kuoromit në Komisionin për të Drejtat e Komuniteteve shtyn rishikimin e buxhetit



PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Në mungesë të kuoromit në mbledhjen e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nuk është shqyrtuar Projekligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit 07/L-001 mbi Buxhetin e Kosovës për vitin 2020, me raport amendamentet e Komisionit Funksional për

Buxhet dhe Transfere. Kryesuesi i këtij komisioni, Albert Kinolli, ka dekluaruar se prej 18 anëtarëve vetëm shtatë deputetë ishin të pranishëm duke pamundësuar kuorumin për shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës. Deputeti i LDK-së, Fetah Rudi, ka thënë se derisa është në karrocë ai dhe i është përgjigjur

mbledhjes së këtij komisioni, nuk arrin të kuptojë pse deputetët e tjera nuk janë në këtë mbledhje. Edhe deputeti i PDK-së, Elmi Reçica, ka thënë se për hir të gjendjes së vështirë nga pandemia, kjo parti mbështet rishikimin e buxhetit. Të pranishëm në këtë komision nuk ishin deputetët e Listës Serbe.


Hoti vizitoi punimet në rrugën nationale Prishtinë - Mitrovicë

VUSHTRRI, 27 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i shoqëruar nga ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka vizituar rrugën nationale Prishtinë-Mitrovicë, në fshatin Gojbull të Komunës së Vushtrrisë, për t'i parë nga afër punimet që po zhvillohen në këtë rrugë. Me këtë rast, kryeministri Hoti tha se bashkë me ministrin Abrashi, me kryetarin e komunës dhe me deputeten e Kuvendit të Kosovës dhe me zyrtarë të tjerë të Ministrisë së Infrastrukturës, kanë dalë përtëparë përparimin e punimeve në këtë rrugë të

rëndësisë kombëtare. “E kam parashik që kjo rrugë është vonuar që sa vjet. Ministri e ka shtuar dinamikën e punës këtu. Do të angazhohemi në qeveri që sa më parë të kryhen procedurat e nevojshme të shpronësimit, për atë segment që lidhet nga rruga para se të hysh në Vushtrri e deri këtu”, tha kryeministri Hoti dhe shtoi se janë duke diskutuar edhe disa propozime për ta lidhur këtë aks rrugor dhe për ta bërë këtë aks rrugor ndërkombëtar deri në veri, deri në kufi.

Më tej, kryeministri Hoti ka falënderuar edhe kryetarin e

komunës për mbështetjen që e ka dhënë bashkë me qytetarët, me komunitetin, për ta bërë të mundur që të mos pengohet dinamika e kësaj rruge. “Unë besoj që në afatin më optimal kohor në komunikim edhe me punëkryesin do të përfundojë kjo rrugë e rëndësisë së veçantë”, tha kryeministri Hoti. Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, tha se punimet në këtë segment të rrugës nationale Prishtinë - Mitrovicë janë në fazën finale dhe shumë shpejt do të punohet edhe në aksin Gojbull - Lum i Madh. Kryetari i Komunës së



Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, falënderoi kryeministrin Hoti për përkushtimin e madh dhe

rritjen e dinamikës së punimeve në këtë aks rrugor tepër të rëndësishëm.

SERBËT DHE SERBIA KUNDËR SHQIPTARËVE DHE UÇK-së E LUFTËS SË TYRE (18)



Shkruan: Kudusi LAMA

Që të kuptojmë se çfarë kanë thënë serbët kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës paraprakisht duhet të kuptojmë mirë veprimet serbe kundër dhe ndaj Kosovës duke mbajtur në vëmendje se, në këtë vend, pra në trojet e pushtuara edhe në hapësirat e Kosovës, ajo ka bërë një luftë të ashpër prej një shekulli, duke vënë në jetë parime të paimagjinueshme kundërnjerëzore që nijhen, por duhet të përsëriten.

Ushtria serbo-sllave ka manifestuar cilësitet më të ulëta të një ushtrie klasike, jo vetëm në luftën e fundit, por në tërë historinë e ekzistencës e të luftërave të saj, deri në ditët tona.

Për t'i konkretizuar evidencoj disa nga parimet udhëheqëse të kësaj ushtrie në luftë, të deklaruara prej vetë serbëve e organeve shtetërore të tyre, me gojë e me shkrim, me urdhra e me dekrete mbretërore. Ato janë:

- Vra dhe masakro pa mëshirë, pa dallim gjinie, moshe dhe uniforme;
- Shkatërron çdo gjë, që është pronë e popullit të pushtuar, që duke e lënë pa asnjë mbështetje ekonomike, të detyrohet të emigrojë;
- Shkatërron çdo gjë që evidenton kulturën shqiptare dhe lashtësinë e saj, përfshirë që të shkulen më lehtë rrënjet e lashtësë kombëtare shqiptare në territori, e në Kosovë, në veçanti;
- Mashtron e gjej mundësi me të gjitha mjetet që të krijohen struktura të armatosura shqiptarësh, të cilat të luftojnë kundër shqiptarëve, duke bërë që të ketë gjithnjë të ndezur një konflikt ndërsqiptar, që të detyrohen të vrasin e të ikin edhe prej njëri-tjetrit;
- Vrit duke pretenduar se po mbrohesh, përdhuno duke pretenduar se po pastrohesh, grabit duke pretenduar se po të grabisin;

- Masakro para popullit, që të ngjallësh tmerr ndër shqiptarët; - Vrit inteligjencien shqiptare, që të mos mund të zhvillojnë kulturën dhe të detyrohen të emigrojnë në vendet e tjera; - Rrismi vlerat para atdheut duke ditur se vlera të tilla kanë vetëm ata ushtarë serbë që arrijnë të zhdukin apo të shpërngulin me forcë sa më shumë shqiptarë, përfshirë krijuar prona të lira për serbët që i meritojnë; - Kombino veprimet ushtarake me veprimet banditeske, duke propaganduar se lufta bëhet pikërisht kundër këtyre banditëve; - Persekuto e masakro në mënyrën më të shfrenuar shqiptarët e mbetur, që të kuptojnë se në këtë vend nuk kanë të ardhme; - Shfatos e shpërngul sepse kjo është detyrë parësore, përfshirë ndërruar raportin e popullsisë në Kosovë, nga favor i shqiptarëve në favor të serbëve, ku ne duhet të jemi patjetër shumicë; - Gjej tek shqiptarët me çdo kusht armë të fshehura, të

çarmatoset popullsia shqiptare e njëkohësisht të armatoset popullsinë serbe, që në çdo rast civilët serb tëjenë krah me ushtrinë përfshirë shfarosjen e shqiptarëve; - Krijo bindjen tek të gjithë se në Kosovë ka të drejtë të jetojë vetëm ai shqiptar që pagëzohet në fenë ortodokse dhe që nuk guxon të flasë gjuhën shqipe "atë gjuhë të ndyrë"; - Shqiptarët në Kosovë të zhvishen nga identiteti i tyre, nga shtëpitë e tyre, nga emërtimet, kujtimet dhe arkivat e tyre; - Edhe të gjithë shqiptarët mund të zhduken në emër të Serbisë së Madhe; - Shfrytëzo fanatzimin etnik dhe fetar të popullit serb përfshirë nxit agresivitetin e tyre kundër shqiptarëve; - Shkatërrimet dhe barbaritë, plaçkitjet, djegjet, rrënimet e çdo gjë që është shqiptare, bombardimet, terrori intensiv, masakrat masive, përdhunimet, zhdukjet e personave, burgosjet masive dhe përdorimi i të gjitha llojeve të armëve, janë dhe

mbeten norma e përhershme e ushtrisë serbe në Kosovë;

- Formimi dhe vullneti politik i popullit të Kosovës të likuidohet me të gjitha mënyrat dhe mjetet e mundshme deri në zhdukjen fizike të tij.

Këto parime nuk mund të janë bashkudhëtare të një ushtrive klasike. Ato janë pjellë e ushtrive barbare e fashiste, që duket se në Serbi kanë lindur para se të lindte barbaria e fashizmi në Botë. Pra, shihet se serbët nuk jetën e tyre kanë përgatitur dhe futur në luftë ushtritë, të cilat kanë luftuar më shumë me popullin e pambrojtur se me forcën e armatosur, që kanë pasur përballë.

Këtë e vërteton edhe harta që kanë punuar përfshirë artillerisë gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, ku duket se është planëzuar zjarr kudo ku ka pasur shtëpi e qendra të banuara, megjithëse me ligjet ndërkombëtare nuk lejohet të planëzohet zjarri i artillerisë më afër se 1500 metra nga shtëpia më e afërt. Hartë origjinale e kohës së luftës e zënë në front të

luftës në çantën e oficerit.

Shikojeni hartën e punuar prej tyre:

Deri me sot, askush ne Serbi nuk e ka dënuar luftën, që urdhëroi Sloboden Milloshevici kundër Kosovës, as reprezaljet dhe vrasjet masive të popullit të paarmatosur. Ky është treguesi i parë që duhet vlerësuar përfshirë kuptuar se Serbia nuk ka hequr dorë prej politikës së saj fashiste. Prandaj edhe vlerësimi e deklarime siç do të njohim më poshtë, që kanë ushqyer raportin e Dick Martyt, nuk duhet të na habisin.

E ardhmja dhe siguria e Kosovës është e garantuar sa kohë që gjithë populli të jetë gati të mbrojë atë me çdo çimim dhe ky popull që luftoj me vetëmohim dje në Luftën Çlirimtare, do të jetë i gatshëm ta bëjë këtë në çdo kohë përfshirë atë me qëndrueshmë. Gjaku shqiptar nuk ndërrrohet, siç nuk është ndërruar me dhjetëra shekuj. Çdo shqiptar duhet të jetë i qartë



se për sa kohë Serbia mendon se do të rikthehet në Kosovë dhe tenton të krijojë situata për t'u rikthyer në Kosovë, lufta vazhdon.

Për sa kohë Serbia tenton të organizojë strukturat e UDB-së në Kosovë dhe me tej, si dhe deklaron edhe publikisht se i ka organizuar ato struktura në shërbim të saj, lufta ende vazhdon.

Për sa kohë vazhdon politika me tentativë për të mbjellë kriminalitetin në Kosovë, për të mbjellë hasmëritë e gjakmarjen midis shqiptarëve, duke inskenuar të ashtuquajturat vrasje ndërshqiptare, lufta ende vazhdon.

Për sa kohë serbët mbeten nën kujdesin ndërkombëtar, duke kriminalizuar popullin dhe jetën shqiptare në Kosovë, lufta vazhdon...

Edhe raporti i paraqitur nga Dick Marty në emër të Evropës, nuk është gjë tjetër veçse një tregues më shumë se lufta vazhdon...

Është shumë i dukshëm fakti se Serbia përpipet përmbijetësët në Kosovë. Ajo duket se nuk e koncepton akoma të vërtetëtë e largimit përfundimtar nga Kosova. Në kushtet që janë krijuar, Serbia po shfrytëzon të gjitha mundësitë për të mbijetuar në Kosovë dhe për të përgatitur shtrat të përshtatshëm dhe një mundësi më shumë për interesat e saj në Kosovë.

Për mbijetesën e saj, Serbia, po shfrytëzon:

Së pari, praninë ndërkombëtare dhe aktivitetin e tyre, duke bërë një propagandë të shfrenuar antishqiptare dhe shpifje të pa konceptueshme, duke ushqyer Evropën e botën me ta, për të arritur deri tek raporti i Dick Martyt në emër të Evropës e deri tek krijimi i tribunalit për krimet e luftës së UÇK-së, që po na u bën presion burrave të Kosovës.

Së dyti, po shfrytëzohen maksimalisht nostalgjikët, të cilët kanë qenë të përkëdhelurit e regjimit kolonial dhe, megjithëse, janë shqiptarë, akoma mbajnë në banesat e tyre portretet e Titos dhe në ndonjë rast edhe të Milosheviqit.

Së terti, në Kosovë jetojnë edhe një masë serbësh, të cilët në çdo moment janë kontingjent i Serbisë dhe punojnë për të.

Së katërti, edhe ish-kuadrot shqiptare të regjimit kolonial luajnë rolin e tyre në këtë situatë, pasi tentohet të joshën.


Së pesti, ish-spiunët janë kontingjenti më i rrezikshëm në Kosovë.

Së gjashti, edhe miqësítë kanë rolin e tyre në lëvizjen Kundër Kosovë të Serbisë.

Së shtati, njohjet dhe shoqërítë e krijuara gjatë bashkëjetësës koloniale.

Së teti, strukturat e UDB-së, që mendojnë se janë e mbeten aktivë.

Së nënti, marrëdhëni tregtare me Serbinë, të cilat zhvillohen



aktivisht dhe do të zhvillohen e zgjerohen dita ditës në të ardhmen.

Së dhjeti, duke mbajtur akoma peng një mori mjetesh e dokumentacioni që është i Kosovës dhe i nevojitet shumë asaj.

Së njëmbëdhjeti, edhe komunikacioni është një mundësi tjetër, që po shfrytëzohet dhe do të shfrytëzohet nga Serbia, për t'i dhënë mesazhet e mbijetesës në Kosovë.

Së dymbëdhjeti, propaganda kundërshtuese është një fushë të cilën Serbia dhe serbët e zoterojnë mirë, dhe siç duket në momentin aktual me raportin e Dick Martyt dhe Gjykatën Speciale për krimet e luftës së UÇK-së, kjo propagandë dhe këto shpifje të Serbisë po kanë edhe sukses në botë.

Së trembëdhjeti, një rol të rendësishëm luan opinioni. Për krijimin e kushteve me të favorshme, për të siguruar opinionin e gjithë se Serbia është e vetmja forcë që mund të disiplinojë Kosovën, makineria serbe e propagandës, por edhe e shërbimeve sekrete duket se punon pa pushim.

Së katërmëdhjeti, ushtrimi i forcës dhe i dhunës, pasqyrë e të cilës janë Mitrovica dhe pikat e kalimit kufitar mes Kosovës e Serbisë, vlerësohet si një element i rendësishëm për ruajtjen e pranisë serbe në Kosovë.

Së pesëmbëdhjeti, në Kosovë vrasjet janë demoduar. Megjithatë, shihet se në mjaftë raste shfaqen vrasje që mbajnë në vete enigma. Ato vlerësojnë se janë vepra serbe për të dhënë mesazhe pasigurie dhe për të

krijuar mundësinë e përcarjes ndershqiptare.

Së gjashtëmbëdhjeti, edhe në ekonomi po ushtrohet trysni e madhe për të mos pasur rezultat, që të paraqitet si i pamundshëm zhvillimi jashtë Serbisë.

Së shtatëmbëdhjeti, presionet politike ndaj Kosovës, janë të pranishme që nga OKB-ja, Evropa, Ballkani, Serbia dhe Kosova.

Duke vlerësuar gjithë këtë hapësirë të veprimeve serbe kundërshtuese, nuk duhet të habitemi as për renditjen e gjithë atij monstruoziteti të renditur në raportin e Dick Martyt, të cilin realisht e vlerësoj si një agresion të ri të Serbisë Kundër Kosovës dhe me krijimin e tribunalit për krimet e luftës së UÇK-së, vlerësoj se Serbia betejën e parë e ka fituar kundërshtuese dhe gjithë shqiptarëve e mbi të dy shtetet shqiptare. Mbetet të shohim vazhdimin. Por shqiptarët duhet të kuptojnë se lufta vazhdon...

Për fat të keq, jo të gjithë e kuptojnë, se në Kosovë akoma hilet janë të pranishme. Kjo e vërtetë, në radhë të parë, vjen nga Evropa, ku luhën ende prapaskena në interes të Serbisë. Këtë e vërteton edhe fakti që në Kosovë serbët, megjithëse, përbëjnë vetëm rreth 2% të popullsisë, bëjnë si të fortë. A mos është akoma e pranishme deklarata e Milosheviqit: "...ne dimë se si duhet t'i qërojmë hesapet me shqiptarët..."?

Por, edhe sa kohë do të vazhdojnë këto hile ndërkombëtare?

Kjo çorbë dihet se gatuhet në kuzhinën e Beogradit, me

regjinë ruse dhe me oponencën e disa evropianëve. Unë mendoj, se Berlini, i cili ka bërë mjaft në të kaluarën kundërshtuese.

Dhe shqiptarëve, por edhe Londra e Parisi gjithashtu, si dhe Roma, që në gjithë historinë e saj ka pasur vetëm lavdi prej shqiptarëve, nuk u lejohet të bëjnë lojë të dyfishtë. Nuk u lejohet ta sundojnë Kosovën me synim për të kthyer në ujë gjakun e derdhur. Nuk shpërbëhen shqiptarët, nuk zhbëhet gjaku i tyre dhe nuk zhbëhet gjeni i tyre luftarak. Ata do të mbeten historikët të tillë, të urtë, të kulturuar, fisnikë, miqësorë, vëllazërorë dhe besnikë, për të gjithë ata që do të ofrojnë këto cilësi. Por, do të janë luftarakë dhe të papërbajtshëm për të gjithë ata që do të tentojnë t'i zhbëjnë e zhdukin.


Le të shohim tani se ku i ka marrë të dhënë raportit të tij Dick Martyt në emër të Evropës:

Shikojeni fotografinë më poshtë që të kuptoni se Serbia nuk na harron. Kush nuk e ka lexuar këtë libër do të bënte mirë ta lexonte për të njohur mirë kush janë "kriminelët më të mëdhenj" shqiptar, që vërtetë i kanë prishur shumë punë Serbisë. Lexojeni titullin e këtij libri dhe kuptoni se kush janë për Serbinë djemtë tanë të luftës, ata që i dhanë përfundimisht lirinë këtij vendi janë, siç përcaktohet në titullin e këtij librit: "Engjëjt e zinj të skëterrës Kosovare" DOSJET "SEKRETE".

Ky libër publikisht është përgatitur nga Millosh Obilić, që njihet si autor i publik i tij. Por duket, se për të ka punuar një grup pune shumë i specializuar, për të ndërtuar figura kriminale

dhe për të ndërtuar struktura mafioze e ushtarake. Është punuar me kujdes që gjithçka të bëhet e të duket sa më origjinale. Prandaj edhe duket që në përpilimin e këtij libri kanë marrë pjesë specialistë të ushtrisë, të policiës, të kriminalistikës, të UDB-së, të shërbimit informativ ushtarak, të kishës dhe të politikës. Gjithë ky potencial specialistësh janë angazhuar për të sjellë në publikun serb e ndërkombëtar këtë libër, i cili është shpërndarë edhe nëpërmjet internetit në gjuhën serbisht dhe anglisht. Ky libër është botuar në Beograd në vitin 2004, me një tirazh 500 kopje dhe mban numrin e ISBN 86-7552-015-8. Në vazhdim do të sjellë gjithë ato pjesë të përbajtjes së këtij libri që duket se janë përdorur në raportin e Dick Martyt, duke bërë sqarimet dhe komentet përkatëse.

Bëhet pra shkas për t'u marrë me këtë punë, raporti i publikuar në emër të strukturave të Bashkimit Evropian nga një person që quhet Dick Martyt, që emërohet raportues i Këshillit të Evropës, i cili nuk thotë asgjë të re veç atyre që janë botuar në librin që po e citojmë gradualisht në vazhdim e që për njerëzit normal janë të njohura, ndërsa për ata si Dick Martyt që janë në shërbim të Serbisë ne nuk kemi pse harxhojmë kohë e mundim për t'i sqaruar, sepse ata nuk shkruan në se nuk dinë të vërtetë, por shkruan në ashtu e dëshirojnë të vërtetë. Sidoqoftë mua më shqetëson një pyetje: Edhe për sa kohë Evropa do të ketë elementë që do të flasin për shqiptarët siç flet Serbia? (Vijon)



Hajdari: Gjilani do ta prezantojë denjësisht Kosovën në Ligën e Evropës

Fiton Hajdari ka thënë për "Epokën e re" se e ka merituar titullin e kampionit në IPKO Superligë. Ai beson se ky klub do ta prezantojë Kosovën në mënyrën më të mirë në garat parakualifikuese të Ligës së Evropës. "Është hera e parë në historinë e Gjilanit që merr pjesë në garat evropiane dhe normalisht se është diçka e veçantë. Kam besim të madh se ky klub do ta përfaqësojë Kosovën në mënyrën më të mirë në Ligën e Evropës", ka thënë Hajdari



EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 KORRIK - Skuadra e Gjilanit e mbylli edicionin 2019/2020 në pozitën e dytë, e cila e dërgon në garat evropiane. Fiton Hajdari të hënën për "Epokën e re" ka thënë se ky sukses është arritur më shumë sakifice. "Kampionatin e përfunduan në vendin e dytë dhe normalisht se jemi të kënaqur me këtë pozitë dhe rezultatet dhe paraqitjet që i kemi treguar gjatë këtij kampionati. Ka qenë një kampionat mjaft i fortë, ku shumë skuadra luftuan për pozitat e para, por ne me shumë sakrificë kemi arritur të dalim nënëkampion dhe ta sigurojmë daljen në Evropë", ka thënë Hajdari, i cili më pas ka treguar pse Gjilani nuk arri i Superligës. "Kanë qenë shumë faktorë jashtë

fushës që ndikuan që Gjilani mos të shpallet kampion", ka shtuar ai. Futbollisti që ishte ndër më të mirët jo vetëm në skuadrën e Gjilanit, por në mbarë Superligën, Fiton Hajdari, ka shprehur optimizëm se gjilanisit do ta përfaqësojnë Kosovën në mënyrë dinjitoze në Ligën e Evropës. "Është hera e parë në historinë e Gjilanit që merr pjesë në garat evropiane dhe normalisht se është diçka e veçantë. Kam besim të madh se ky klub do ta përfaqësojë Kosovën në mënyrën më të mirë në Ligën e Evropës", ka thënë Hajdari.

Futbollisti me tipare sulmuese do të marrë pjesë për herë të dytë në garat ndërkombëtare, pasi një gjë të tillë e kishte bërë vite me parë kur Trepça '89 mori pjesë në garat e Ligës së Kampionëve. Hajdari ndihet i lumtur që sërisht ka mundësinë të paraqitet në garat

evropiane dhe beson se Gjilani do të prezantohet mirë. "Është hera e dytë që marr pjesë në garat ndërkombëtare. Herën e parë ishte shumë e veçantë pasi ishte hera e parë në historinë e futbollit të Kosovës që klubet merrnin pjesë në garat ndërkombëtare dhe emocionet ishin më ndryshe. Tash kam përvøjë më të madhe dhe do të përpinqemi të paraqitemi sa më mirë dhe të arrijmë sa më lart që është e mundur", ka deklaruar ai. Në fund Hajdari ka bërë me dije se kontrata me skuadrën e Gjilanit i ka përfunduar, por nuk e përjashton mundësinë që të mbetet pjesë e këtij klubit edhe në sezonin e ri. "Kontrata më ka mbaruar, por kemi filluar bisedimet me Gjilanin dhe mbetet të shihet se a do të arrijmë marrëveshje bashkëpunimi edhe për të ardhmen", ka deklaruar Hajdari.

SHKURT

Prepolli ndahet me Flamurtarin

Flamurtari nga Prishtina nuk arriti ta sigurojë mbi jetesën në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, kurse të hënën nga ky klub është larguar ndihmë trajneri Arsim Prepolli. Trajneri në fjalë nuk ka bërë me dije arsyen e largimit, derisa klubit kuezi i ka uruar rikthim sa më të shpejtë në Superligë. "Që nga sot nuk do të jem pjesë e Flamurtarit. Dua t'i falënderoj të gjithë për bashkëpunimin. Suksese dhe ju dëshiroj rikthim sa më të shpejtë në Superligë", ka thënë Prepolli.

Llapi vazhdon bashkëpunimin me Prençin

Vetëm një ditë pasi përfundoi kampionati elitar i futbollit në Kosovë, skuadra e Llapit e ka vazhduar bashkëpunimin me mbrojtësin nga Shqipëria, Elvis Prençin.

Lajmi është konfirmuar nga faqja zyrtare e Llapit në rrjetin social "Facebook".

"KF Llapi ka 'blinduar' edhe për një edicion tjetër qendërmbrötësin Elvis Prençin, i cili do të vazhdoj t'o mbroj ngjyrat e klubit edhe në edicionin e ri 2020/21. Duke parë rëndësinë e tij për skuadrën dhe kontributin që jep në fushën e lojës, klubti menjëherë ka finalizuar marrëveshjen me Prençin, njërin prej futbollistëve kryesorë të klubit. Prenç tashmë një vit e gjysmë nga ardhja në Llap ka qenë i pazëvendësueshëm, ndërsa në edicionin 2019/20 ka zhvilluar gjithsejtë 32 paraqitje (31 kampionat/1 kupë) për Llapin duke realizuar edhe një gol", thuhet në njoftimin e Llapit.

Blakçori konfirmon largimin nga Ferizaj

Portieri Armend Blakçori nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook" ka konfirmuar largimin nga skuadra e Ferizajt. Ky klub sezoni i ardhshëm do të bëjë gara në Ligën e Parë. "Me përfundimin e kampionatit ka përfunduar edhe kontrata ime me FC Ferizaj dhe më nuk do të jem pjesë e këtij klubit. Ishte nder dhe kënaqësi që isha pjesë e klubit. I falënderoj të gjithë ata me të cilët bashkëpunuam për dy vjet e gjysmë. Falënderim i veçantë shkon për 'Ujqit' që gjithmonë më kanë përkrahur. Shpresoj se Ferizaj do të rikthehet prapë aty ku e ka vendin në Superligë", ka shkruar Blakçori.

Kërkesa e Leipzigut për Rashicën nuk e kënaqë Bremenin

Werder Bremen kërkon 25 milionë euro për kartonin e Milot Rashicës, kurse Leipzigu ofron vetëm 15 milionë euro. Për momentin, Leipzigu nuk është i gatshëm t'i ofrojë më shumë se 15 milionë euro, plus bonuset, varësisht prej arritjes së objektivave të klubit dhe vetë lojtarit. Për momentin dallimi në mes të kërkesës dhe ofertës është 10 milionë euro. Gjithashtu, interesim për Rashicën kanë shfaqur edhe Borussia Dortmundi e Hertha Berlini në Gjermani, Milani, Napoli e Lazio në Itali dhe Liverpooli, Aston Villa, West Hami e Wolverhamptoni në Angli.

Presidenti i Dritës: Kemi shpenzuar mbi një milion euro

GJILAN, 27 KORRIK - Titulli kampion në Kosovë ishte diçka e papritur edhe për vetë presidentin e Dritës, Valon Murseli. Numri një i intelektualëve i kishte vendosur si objektiv kryesor skuadrës për këtë sezon futbollistik kualifikimin në Ligën e Evropës, pra vendin e

dytë në kampionat. "Në filim të kampionatit jemi ulur me kryesinë dhe kemi folur çfarë presim nga Drita dhe lojtarët e trajneri. Dëshira ishte dalja në Evropë, titulli ishte i dyti. Kishim qenë të kënaqur edhe me vendin e dytë. Para dy vjetëve kemi bërë shumë gabime, dolëm

kampionë, por kishte eufori dhe i harruam lojtarët si Fazliu dhe iku Rexha, por këtë sezoni jemi përgatitur për këto gjëra", ka thënë Murseli. "Dua t'ju them se lojtarët e huaj cilësorë nuk po vijnë në Kosovë. Ata po hezitojnë të luajnë në Kosovë. Nuk ka infrastruk-

turë për të sjellë yje këtu. Pra, ky është problemi. Ne mund të sjellim lojtarë cilësorë, por 34 vjeç, të rinjtë dhe të mirët nuk mund t'i sjellim. E kemi nisur me 200 mijë euro investime, në vitin tjetër e kemi rrit me 600 mijë dhe këtë sezoni mbi një milion euro", ka shtuar Murseli.



Pushkolli: Motiv për vajzat e reja të punojnë më shumë

PRISHTINË, 27 KORRIK - Kosova A (femrat) pritet të marrë pjesë në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla që do të organizohet në vitin e ardhshëm në Nicosia të Qipros prej 15 deri më 20 qershor. Formimi dhe pjesëmarrja në garat ndërkombëtare është një motivim i madh për vashat e reja që kanë të dhëna evropiane. Një ndër to është edhe Dea Pushkolli, e cila luan në ShBA. "Padyshim se është një vendim shumë i mirëpritur dhe lajm i mirë formimi dhe përfaqësimi në garat ndërkombëtare. Një sukses i FBK-së dhe një hap i rëndësishëm përbën basketbollistet e Kosovës. Do të jetë një shtytje për vajzat e reja që të punojnë më shumë. Fillimisht do të jetë sfiduese për të arritur suksese, por nëse do të ketë përgatitje konsistente profesionale dhe përkrahje institucionale,



suksesi gradualisht nuk do të mungoj", është shprehur Pushkollit për faqen zyrtare të FBK-së. Në FIBA Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla-Femrat në vitin 2020 janë paraqitur për të garuar: Andorra, Qipros, Gjibraltari, Irlanda, Luksemburgu, Malta dhe Norvegjia, por që u anulua për shkak të pandemisë Covid-19.

Regjistrimi i shteteve për pjesëmarrje në FIBA Kampionate Evropiane në FIBA Europe do të bëhet si zakonisht, pra ndërmjet muajve shtator/tetor 2020. FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha federatat nationale që t'i regjistrojnë ekipet e tyre për vitin 2021, pasi regjistrimet e paraqitura për vitin 2020 nuk do të merren parasysh.

Immobile, Lewandowski dhe Ronaldo, në garë për 'Këpucën e Artë'

ROMË, 27 KORRIK - Duke parë numrin e lartë të golave ishte vërtet shumë e vështirë të mendoje Ciro Immobile jashtë garës sezionale për "Këpucën e Artë" dhe bomberi i Lazios, pasi u kalua nga Robert Lewandowski, arriti t'i rifitojë kuotat duke iu bashkuar polakut në krye.

pokalut në krye. Trofeu individual për numrin e rrjetave të shënuara ka hyrë në një fazë kulmore, e tani lojtari i Bayernit ka kërçënimin serioz nga Seria A. Immobile ka barazuar me Robert Lewandowski, por ky i fundit nuk ka më shanse për të shënuar pasi Bundesliga ka përfunduar të gjitha ndeshjet. Në kontrast me kampionatin gjerman, Seria A ofron 180 minuta të tjera që sulmuesi i Lazios në kuotën 34 gola, të provojë të distancohet nga rivali dhe për këtë mund të shërbejë ndeshja në "Olimpico" ndaj Brescias dhe më pas transferta



ndaj Napolit në stadiumin "San Paolo"

Paolo. Italiani i fundit që ka fituar "Këpucën e Artë" është Françesko Toti në 2007. I vetmi kërcënëm që mund ta prishë festën e pritshme të Immobile është portugezi Cristiano

Ronaldo. Futbollisti që inspiroi Juventusin drejt rikonfirmimit në fron është në kuotën 31 gola dhe ka në dispozicion sfidat ndaj Caljarit dhe Romës, për të provuar të kalojë si Immobile, ashtu edhe polakun Lewandowski të Bayernit.

SHKURT

Vardy shpallet golashënesi më i mirë në Premierë Ligë

Jamie Vardy shpallet golashënuesi më i mirë i Premierë Ligës për sezonin 2019-2020. Sulmuesi 33-vjeçar i Leicester City e mbylli kampionatin anglez me 23 gola, një më shumë se Pierre-Emerick Aubameyang dhe Ings i Southamptonit. Për veteranin e "Dhelprave" ky çmim individual nuk vjen në mënyrën e duhur, pasi pikërisht në javën e fundit Leicesteri humbi mundësinë për të marrë pjesë në Champions League në sezonin ardhshëm. Vardy nuk mundi ta gjente rrjetën në përballjen m Manchester United (0-2). Në këtë javë të fundit Aubameyang realizoi dy gola në fitoren e Arsenalit përballë Watfordit (3-2), ndërsa Ings shënoi golin e tretë në suksesin 3-1 të Southamptonit ndaj Sheffield Utd, por pa mundur të barazinin me Vardyn.

Vertonghen pas tetë vjetëve largohet nga Tottenhami

Mbrojtësi belg Jan Vertonghen ka njoftuar për fundin e aventure së tij në Londrën veriore. Vertonghen është pa kontratë te skuadra e "Spurs" dhe pas ndeshjes së fundit dje, lojtari ka njoftuar për fundin e rugëtimit. Përmes një postimi në llogarinë e tij në rrjetin social 'Twitter', belgu ka falënderuar klubin dhe tifozët e Tottenhamit. "Pra, koha ime me klubin erdhi te fundi. Ditë e dhimbshme për shumë arsy. Do të më mungojnë shokët që kam bërë këtu, stafi që bëri klubin, të luaj në stadium të mrekullueshëm dhe sigurisht tifozët", ka shkruar Vertonghen. "Faleminderit për mbështetjen gjatë këtyre viteve. Keni qenë të mrekullueshëm. Ne kemi pasur shumë kujtime të pabesueshme por për tanë, është lamtumirë", ka shkruar belgu. Vertonghen ka kaluar plot tetë viet me skuadrën nga Londra veriore.

Van Dijken befason Kloppin

Jurgen Klopp këmbëngul se Virgil van Dijkut nuk i nevojitej më shumë lavdërim pas kompletimit të një sezoni mbresëlënës me Liverpoolin, edhe pse e pranoi se mbrojtësi holandez e ka tejkaluar çdo pritje. Van Dijk nuk ka munguar as edhe një minutë për Liverpoolin në Premierligë këtë sezon, duke i ndihmuar skuadrës ta fitojë titullin dhe ta lërë 18 pikë mbrapa rivalin Manchester City. Përfaqësuesi i Holandës kishte luajtur çdo ndeshje edhe në sezonin paraprak 2018/19 në ligë, kur të kuqtë e kishin humbur titullin në ditën e fundit ndaj City. Van Dijk është vlerësuar si një prej qendërbrojtësve më të kompletuar dhe më vazhdimësinë më të madhe në Premierligë që prej se iu bashkua Liverpoolit nga Southamptoni, por Klopp thotë të jetë mahnitur nga mendësia e tij. "Nuk jam i sigurt se ai ka nevojë për edhe një orë lëvdata. Ai është i mirë, shumë i mirë. Ai është qendërbrojtës i madh. Ne e dinim kur e blemë se morëm një lojtar shumë të mirë, por në përgjithësi doli të jetë i veçantë. Nuk e dinim këtë", ka thënë Kloppi.

Pogba s'larqohet nga Unitedi

Paul Pogba ka lënë të kuptohet se e ardhmja e tij qëndron te Manchester Unitedi, ndërsa shpreson të arrijë suksese me “Djajtë e Kuq” në Ligën e Kampionëve. Klubi anglez e siguroi pjesëmarrjen në garën më të madhe evropiane duke e mbyllur sezonin në pozitën e tretë në Ligën Premiere. Nga ana tjetër, gjatë sezonit 2019/2020 është spekuluar vazhdimit se mes-fushori francez do të largohet nga “Old Trafford”, me Real Madridin dhe Juventusin të interesuar për shërbimet e tij. Megjithatë, duke qenë se për shkak të krizës së pandemisë globale, klubet e kanë të vështirë të paguajnë shuma të majme parash, interesimi për të është zbehur. Ndërsa pas sigurimit të një vendi në top-katërshe, 27-vjeçari ka shkruar në rrjetet sociale: “Shkojmë në Ligën e Kampionëve, zemër”.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KOMISIONI KOMUAL I AKSIONARËVE I KOMPANISË REGJIONALE TË MBETURINAVE “ÇABRATI” SH.A.

Nr.01-111/01-16158
Dt. 28.07.2020

Komisioni Komunal i Aksionarëve i Kompanisë Regjonale të Mbeturinave “Çabrat” Sh.A, në bazë të nenit 16, 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087, shpall këtë:

KONKURS

Për zgjedhjen e një (1) anëtarë të Bordit të Drejtoreve për Ndërmarrjen Publike Lokale KRM “Çabrat” Sh.A.

Mandati i anëtarit të bordit është në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087.

KUALIFIKIMET DHE PËRGADITJA PROFESIONALE

- Të jetë person që ka integritet, të mos ketë çfarëdo shkelje fiduciare ndaj personave tjerë fizik dhe juridik;
- Të ketë përgatitje superiore;
- Të ketë se paku pesë (5) vjet përvjetore punë në nivel të lartë të menaxhimit – në fushën e administrimit të biznesit, të financave kooperative, të menaxhimit të thesarit, të bankave, konsulent në biznes ose industri, ose nga fushat e tjera të shkencave, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër, i cili ndërlidhet ngushtë më veprimtaritë afarist të NP-së.

KUSHTET

Kandidatët kanë të drejt të zgjedhën në bordet e NPL-së nëse:

- Nuk kanë qenë të dënuar dhe nuk janë nën hetime nga ndonjë gjykatë kompetente;
- Nuk kanë shkelur Kodin e Etikes apo standartet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga gjykata ose nga ndonjë organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgënjeshtrimin e materialit nën çfarëdo dëshmie nën betim, nuk ka qenë në poste menaxheriale në ndonjë kompani që ka falimentuar në 10 vitet e fundit.

Kandidatët nuk mund të zgjidhen në bordet e NPL-së nëse:

- Aktualisht është zyrtar, menaxher i ndërmarrjes përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, ose ka shërbyer si menaxher i ndërmarrjes publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj 5 vitet e fundit;
- Aktualisht ka, ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie materialo- afariste (përveç si konsumator individual i shërbimit të Ndërmarrjes Publike) me Ndërmarrjen Publike përkatëse,

ose cilëndo nga filialet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tertiortë;

- Është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në ndonjë shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Pranon ose ka pranuar brenda tri viteve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj (përveç honorarit të drejtorit ose kompensimin stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 Ligjit të Ndërmarrjet Publike, ose anëtar në skemën pensionale të NP përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj);
- Përfaqëson një aksionar i cili posedon dhjetë përqind (10%) të aksioneve votuese në NP përkatëse;
- Ka shërbyer në bordin e drejtoreve të NP përkatëse më shumë se nëntë (9) vite nga zgjedhja e parë të tij/saj;
- Është i afërt i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e ‘Interesit Financiar’ në nenin 2 të këtij ligji) i cilitdo person që i takon cilësdo nga kategoritë e më sipër;
- Është zyrtar, drejtor ose aksionar ose ka interes Financiar, në shoqëri tregtare të pa-listuar dhe që konkuron në ndërmarrjen, ose menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se 2% të të drejtave të votimit) ose ka interes të konsiderueshëm Financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuar që konkurrojnë në Ndërmarrje;
- Është ose në çfarëdo kohë gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik, bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikti të interesit që për nga natyra, do të shkaktohet që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbush detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve në NP.

DOKOMETET E KËRKUARA

- CV-në;
- Letër motivuese;
- Deklaratë nën betim (formular që plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Dëshmitë e kualifikimit profesional;
- Dëshmitë mbi përvojën e punës;
- Certifikatën që nuk është nën hetime;
- Kopjen e dokumentit identifikues.

Aplikuesi duhet të përgatitë deklaratën nën betim, në të cilën deklaron që ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësinë dhe përgatitjen profesionale.

Çdo informatë e pavërtetë materiale, qoftë e qëllimshme, qoftë nga neglizhencë, do të rezultojë më diskualifikim të menjëhershëm.



REPUBLIKA E KOSOVËS
EPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**OPŠTINSKA KOMISIJA AKCIONARA REGIONALNE KOMPANIJE ZA
OTPAD "ČABRATI" AD.**

Br. 01-111/1-16158

Dt. 28.07.2020

Opštinska komisija akcionara Regionalne kompanije za otpad "Čabrat" AD, na osnovu člana 16, 17 Zakona o Javnim Preduzećima Br.03 / L-087, objavljuje ovaj:

KONKURS

Za izbor **jednog (1)** člana Upravnog Odbora za Lokalno Javno Preduzeće RKO „Čabrat“ AD.

Mandat člana odbora je u skladu sa Zakonom o Javnim Preduzećima br.03 / L-087.

KVALIFIKACIJE I PROFESIONALNO OBUCAVANJE

- Da bude osoba koja ima integritet, a ne da ima fiducijarnih prekršaja prema drugim fizičkim i pravnim licima;
- Da ima vrhunsku pripremu;
- Da ima najmanje pet (5) godina rano iskustva u nivou višeg iskustva u menadžmentu - u oblasti poslovne administracije, kooperativnog finansiranja, upravljanja trezorskim bankama, bankarskog, poslovog ili industrijskog konsultanta ili druge oblasti nauke, da je bio javni računovođa, kvalifikovani pravnik ili kvalifikovan član druge profesije, što je usko povezano sa poslovnim aktivnostima RJ-ce.

USLOVI

Kandidati imaju pravo da budu birani u odbore JLP-ča ako:

- Nisu osuđeni i nisu pod optužbom u nekom nadležnom sudu;
- Nisu prekršili Etički kodeks ili standarde profesionalnog ponašanja, osim ako takvu kaznu nije promenio sud ili drugo apelaciono telo;
- Nije odbacio materijal pod bilo kakvom izjavom pod zakletvom, nije bio na rukovodećim pozicijama u nijednoj kompaniji koja je bankrotirala u poslednjih 10 godina.

Kandidati ne mogu biti birani u odbore JLP ako:

- Je trenutno službeno lice, rukovodilac odgovarajućeg preduzeća ili bilo koje od njegovih podružnica, ili je bio direktor odgovarajućeg javnog preduzeća ili bilo koje njegovе podružnice u poslednjih 5 godina;
- Trenutno je, ili u protekle tri godine, imao bilo kakav materijalno-poslovni odnos (osim kao pojedinačni kupac servisa Javnog preduzeća) sa relevantnim Javnim preduzećem, ili bilo kojim od zavisnih preduzeća, bilo direktno ili indirektno ;
- Je akcionar, direktor, zvaničnik ili stariji zaposleni u kompaniji ili drugom pravnom licu koji ima materijalni poslovni odnos sa relevantnim PJ-om ili bilo kojom njegovom podružnicom;
- Prima ili je primio u poslednje tri godine dodatnu nadoknadu od odgovarajuće PJ ili bilo koje od njegovih podružnica (pored naknade direktora ili podsticajne naknade utvrđene u članu 20.1 Zakona o javnim preduzećima ili članu penzijskog sistema Relevantno PJ ili bilo koje od njegovih podružnica;

- Predstavlja akcionara koji poseduje deset odsto (10%) glasačkih akcija u dotičnoj PJ;
- Služio je u upravnom odboru odgovarajuće PJ-e više od devet (9) godina od prvog izbora;
- Je blizak trećeg stepena (kako je utvrđeno u skladu sa definicijom „finansijske kamate“ iz člana 2 ovog zakona) bilo koje osobe koja pripada bilo kojoj od gore navedenih kategorija;
- Da li je funkcioner, direktor ili akcionar ili ima finansijski interes u kompaniji koja nije kotirana na tržištu i takmiči se u preduzeću, ili viši menadžer, funkcioner, direktor ili akcionar (koji poseduje više od 2% glasačka prava) ili ima značajan finansijski interes u bilo kojoj od navedenih kompanija koje se takmiče u Preduzeću;
- Da je ili u bilo koje vreme u periodu od 36 meseci pre datuma prijave izabran javni funkcioner, politički imenovani, nosilac rukovodećeg ili rukovodećeg položaja u političkoj stranci;
- Da ima bilo kakav sukob interesa koji će po prirodi uzrokovati da ta osoba ne može rutinski, verno, nezavisno i objektivno izvršavati svoje fiducijarne dužnosti prema akcionarima. u PJ.

POTREBNA DOKUMENTA

- CV-;
- Motivaciono pismo;
- Izjava pod zakletvom (obrazac se popunjava u trenutku predaje dokumentacije);
- Dokaz o profesionalnoj kvalifikaciji;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Sertifikat da nije pod istragom;
- Kopija identifikacionog dokumenta.

Podnositac prijave mora pripremiti izjavu u kojoj izjavljuje da ispunjava uslove za kvalifikaciju, nezavisnost i stručno sposobljavanje. Svaka lažna materijalna informacija, bila ona namjerna ili nepažljiva, rezultirat će momentalnom diskvalifikacijom.

Prijavni obrasci mogu se naći u Službi za informisanje u centralnoj zgradi Opštine Đakovica, na zvaničnoj veb stranici opštine <https://kk.rks-gov.net/gjakove>, u Lokalnom javnom preduzeću RKO "Čabrat" AD i na zvaničnoj veb stranici ovog Preduzeća.

Popunjena dokumentacija mora se predati u zatvorenoj koverti kancelariji sekretara Lokalnog javnog preduzeća RKO „Čabrat“ AD.

Pažnja: Sva dokumentacija podneta u otvorenoj koverti neće se uzeti na razmatranje i smatraće se nevažećom.

Primedba:

Dokumentacija se dostavlja u kopiji, original se mora predstaviti tokom intervjuja. Samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume prema ovom konkursu će se kvalifikovati za naredne faze.

Rok za prijavu je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljinjanja javnog oglasa sa početkom: 28.07.2020 do 11.08.2020, u 16:00. h

Republika e Kosovës Komuna e Malishevës Drejtoria Për Arsimin dhe Edukim																																																																	
Nr: 11/ Me: _____																																																																	
<p>Në baza të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsimin dhe Edukim shpallo:</p> <p>KONKURS Për plotësimin e vendeve të punës Viti shkollor 2020/2021</p> <p>PRANUAR MË: ACCEPTED ON: 27-07-2020 PRIMILJENO: M. 612</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Niveli, Shkolla</th> <th>Pozita</th> <th>Vendi i lirë/zevendësim</th> <th>Numri i pozitive</th> <th>ore</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>SHFMU "Naim Frashëri" në Banjë</td> <td>Mësim klasorë</td> <td>Zevendësim i lehonise</td> <td>1</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>SHFMU "Dëshmoret e Kombit" Ngucat</td> <td>Mësim klasorë</td> <td>Zevendësim i lehonise</td> <td>1</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>SHFMU "Kajtaz Ramadani" Kijeve</td> <td>Mësim klasorë</td> <td>Zevendësim i lehonise</td> <td>1</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>SHFMU "Kajtaz Ramadani" Stafanicë</td> <td>Mësim klasorë</td> <td>Zevendësim i lehonise</td> <td>1</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>SHFMU "Kajtaz Ramadani" Guilboc</td> <td>Mësim klasorë</td> <td>Vendi i lirë</td> <td>1</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>SHFMU "Hasan Prishtina" Terpezë</td> <td>Mësim Klasor</td> <td>Vendi i lirë</td> <td>1</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>7</td> <td>SHFMU "Hilm Hoti" në Carrallukë</td> <td>Edukate Muzikore</td> <td>Vendi i lirë</td> <td>1</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>8</td> <td>SHFMU "Ramadan Morina" Damane</td> <td>Gjuhë angleze</td> <td>Vendi i lirë</td> <td>1</td> <td>14</td> </tr> <tr> <td>9</td> <td>Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë</td> <td>shtëpiak/mjeshtër</td> <td>Vendi i lirë</td> <td>1</td> <td>40</td> </tr> </tbody> </table>						Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zevendësim	Numri i pozitive	ore	1	SHFMU "Naim Frashëri" në Banjë	Mësim klasorë	Zevendësim i lehonise	1	20	2	SHFMU "Dëshmoret e Kombit" Ngucat	Mësim klasorë	Zevendësim i lehonise	1	20	3	SHFMU "Kajtaz Ramadani" Kijeve	Mësim klasorë	Zevendësim i lehonise	1	20	4	SHFMU "Kajtaz Ramadani" Stafanicë	Mësim klasorë	Zevendësim i lehonise	1	20	5	SHFMU "Kajtaz Ramadani" Guilboc	Mësim klasorë	Vendi i lirë	1	20	6	SHFMU "Hasan Prishtina" Terpezë	Mësim Klasor	Vendi i lirë	1	20	7	SHFMU "Hilm Hoti" në Carrallukë	Edukate Muzikore	Vendi i lirë	1	8	8	SHFMU "Ramadan Morina" Damane	Gjuhë angleze	Vendi i lirë	1	14	9	Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë	shtëpiak/mjeshtër	Vendi i lirë	1	40
Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zevendësim	Numri i pozitive	ore																																																												
1	SHFMU "Naim Frashëri" në Banjë	Mësim klasorë	Zevendësim i lehonise	1	20																																																												
2	SHFMU "Dëshmoret e Kombit" Ngucat	Mësim klasorë	Zevendësim i lehonise	1	20																																																												
3	SHFMU "Kajtaz Ramadani" Kijeve	Mësim klasorë	Zevendësim i lehonise	1	20																																																												
4	SHFMU "Kajtaz Ramadani" Stafanicë	Mësim klasorë	Zevendësim i lehonise	1	20																																																												
5	SHFMU "Kajtaz Ramadani" Guilboc	Mësim klasorë	Vendi i lirë	1	20																																																												
6	SHFMU "Hasan Prishtina" Terpezë	Mësim Klasor	Vendi i lirë	1	20																																																												
7	SHFMU "Hilm Hoti" në Carrallukë	Edukate Muzikore	Vendi i lirë	1	8																																																												
